

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE**  
**“DEKO Solution Albania”**

Në Tiranë, sot me datë 09/04/2026 (nëntë prill dymijë e njëzet e gjashtë),

**1. z. Dritan Caf Xhaferi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11/04/1972, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Durrësit ” Pall.228, Njësia Bashkiake Nr.10; person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit me nr. Personal H20411110U;

**2. “DEKO Solution LLC”**, person juridik/ shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me Unique ID No. 810862781, VAT, Number 330324343, me adresë: “Rr. Tirana C4/3 LA – A, Nr.1”, Prishtinë, Kosovë, e e përfaqësuar nga administratori Genc Ajeti.

Me vullnet të lire e të plotë, si themelues të kësaj shoqërie, bazuar dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosën të hartojnë këtë, statut, i cili do të përfshijë dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

Në këtë akt:

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut dhe akt themelimi i shoqërisë;
  - “Ortak/ët”- “Themelues/it”, janë z. Dritan Caf Xhaferi dhe “DEKO Solution” LLC;
- “Shoqëria” është “DEKO Solution Albania”
- Për çështje të paparashikuara në statut, ortakët i trajtojnë me mirëkuptim, brenda hapësirave të legjislacionit në fuqi.

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Objekti**

1. Sot, me datë 9 Prill 2026, Ortakët vendosën të themelojnë Shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar, të emëruar **“DEKO Solution Albania”** Tiranë, emërtimi i të cilës do të jetë i stampuar dhe në vulln e saj.
2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, por pa u kufizuar në:

- (i) import, eksport, tregtim, distribucion, përfaqësim, instalim, montim, konfigurim, mirëmbajtje, servis dhe suport teknik të zgjidhjeve digital signage, LED screens, LCD/professional displays, video walls, projectors, interactive displays, touch screens, commercial displays, menu boards, information kiosks dhe pajisjeve të ngjashme vizuale e elektronike;
- (ii) tregtim, instalim, mirëmbajtje dhe integrim të self-service kiosks, self-payment terminals, cash handling systems, self-checkout systems, payment terminals, retail automation systems dhe zgjidhjeve të tjera për pagesa, arkëtim, automatizim dhe optimizim të proceseve në pikën e shitjes;
- (iii) tregtim, distribucion, integrim, instalim dhe suport të pajisjeve dhe zgjidhjeve POS, Auto ID, barcode scanners, mobile computers, label/receipt printers, handheld terminals, inventory systems, smart terminals, fiscal/retail peripherals dhe pajisjeve të tjera për retail, logjistikë, horeca, depo, farmaci, industri dhe sektorë të tjerë;
- (iv) programim, implementim, integrim, konfigurim dhe mirëmbajtje të software-ve, platformave, licencave dhe aplikacioneve që lidhen me sistemet e mësipërme;
- (v) ofrim i zgjidhjeve të plota “turn-key”, përfshirë projektim, konsultim, instalim, trajnim, mirëmbajtje, menaxhim projektesh dhe shërbime pas shitjes;
- (vi) përfaqësim tregtar, ndërmjetësim, lidhje kontratash, zhvillim rrjeti shitjeje dhe partnerësh në emër dhe për llogari të shoqërive vendase ose të huaja;
- (vii) import-eksport, magazinim, logjistikë dhe transport për nevojat e shoqërisë ose të të tretëve;
- (viii) çdo aktivitet tjetër të ligjshëm tregtar, shërbimi, industrial, teknologjik apo financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur dhe që shërben interesave të shoqërisë.

## **Neni 2:**

### **Selia**

1. Selia qendrore e shoqërisë është në adresën: Rr. “*Hiqmet Delvina*”, Nd. 4, H.2, Tiranë, 1022, Albania. Adresa elektronike e shoqërisë është si vijon: [info@dekosolution.al](mailto:info@dekosolution.al)
2. Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi, depo, pika shitjeje ose seli dytësore brenda Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

### Neni 3:

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë do të jetë *e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*, duke filluar që nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

## KREU II

### KAPITALI THEMELTAR

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është **20.000.000 (njëzet milion) lekë**, i ndarë në 2 kuota, secila me vlerë të barabartë prej **10.000.000 (dhjetë milion) lekësh**, dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para.

2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**Ortakut themelues, z. Dritan Xhaferi**, i përket 1 (një) kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar, me vlerë totale 10.000.000 lekë.

**Ortakut themelues, "DEKO Solution LLC"**, i përket 1 (një) kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar, me vlerë totale 10.000.000 lekë.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- (2) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- (3) shitblerjes;
- (4) trashëgimisë;
- (5) dhurimit;
- (6) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me pëlqimin paraprakt të ortakëve.

1. Ortakët e Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes sipas ligjit. Pjesët e kapitalit themeltar duhet ti ofrohen për shitje ortakëve të shoqërisë me përparësi, në përputhje me ligjin. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk shprehin interes për blerjen e kuotave ato mund ti ofrohen lirisht palëve të treta jashtë shoqërisë.
2. Në rast se kuotat e kapitalit themeltar i shiten njërit nga ortakët themelues këta kanë të drejtën e shlyerjes së çmimit të kuotës sipas marrëveshjes të dakortësuar në mes të palëve.

## KREU II ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 8

#### Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - (a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - (b) ndryshimet e statutit;
  - (c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - (d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (dh) përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin;
  - (e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - (f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - (g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- (g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- (h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- (i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme.**

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga Ligji, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar nga Ligji.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi të dhënë në formë shkresore nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, i cili është i vlefshëm vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi
3. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, për të miratuar inventarin dhe bilancin, raportin e administratorit dhe raportin e kontabilistit publik të certifikuar.
4. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas kësaj pike, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
5. Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend të ndryshëm nga selia e regjistruar, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe me audio ose video konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen nga kryesuesi dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktive në të. Pas verifikimit të këtyre kërkesave, të cilat duhet të paraqiten në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur në vendin ku janë të pranishëm Kryetari dhe Sekretari i Mbledhjes.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë unanimitet, sipas përcaktimve në këtë statut, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse të gjithë ortakët, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me unanimitet, për çështje të tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Përfshirja nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- e) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

#### Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator Shoqërisë.
- (3) Të dhënat e identifikimit

<p><b>Ortaku, Dritan Caf Xhaferi.</b></p> <p>Ky statut dhe nënshkrimi i tij nga ortakët, konsiderohet si autorizim i posaçëm, sipas parashikimeve të nenit 17 të Ligjit.</p>	<p>Numër Personal: <b>H20411110U</b></p>
--	--

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit, Administratori detyrohet:
2. Të Posaçme:
  - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë

realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen ortakëve kontributet;
  - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

### KREU III

#### VITI FINANCIAR, EKSPERTËT

##### Neni 16

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### Neni 17

##### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për kryerjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## Kreu IV

### PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e Shoqërive Tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

##### Riorganizimi i shoqërisë bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### Neni 21

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit. Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 21

##### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

**Nënshkrimi**

<p>Ortakët</p> <p><b>Emër, Mbiemër, Firme,</b> <b>Dritan Caf Xhaferi</b></p> <p><b>“DEKO Solution LLC”</b></p>	<p>Dritan Xhaferi </p> <p>GENC AJETI </p>
--	---